



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FIER

Nr. 3584 Prot

Fier, me 21.03.2025

PROJEKT - VENDIM

Nr. 83, datë 21.03 2025

“Per miratimin e projektit: RIKONSTRUKSIONI I RRUGES "KASTRIOT MUÇO" SEGMENTI (KRYQEZIMI ME RR. "MUJO ULQINAKU"- KRYQEZIMI ME UNAZEN "SKENDERBEU"), (ZGJERIMI I RRUGES)

Në mbështetje të nenit 54 të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, si dhe duke marrë shkas nga zhvillimet e fundit të qytetit dhe investimeve të Bashkisë Fier në infrastrukture verehet nevoja e një zgjerimi të segmentit rrugor “Kastriot Muço” (kryqezimi me rrg. “Mujo Ulqinaku” deri tek kryqezimi me unazen “Skenderbeu”.

Kjo nevojë për zgjerimin e segmentit të rrugës vjen si pasoje e zhvillimit të qytetit në këte drejtim. Në këte pjesë të qytetit kohët e fundit janë ndërtuar dhe zhvilluar biznese të mëdha dhe të rendesishme dhe me impakt të lartë në qytet. Një nga investimet e mëdha të Qeverisë Shqiptare në këte pjesë të qytetit është dhe Spitali Rajonal “Memorial”, i cili me nisjen e aktivitetit të tij e rriti ndjeshëm fluksin e lëvizjes në këte drejtim. Gjithashtu dhe rikonstruksioni total që pësoi rruga e Celigradit, e dikton këte zgjerim rrugë që propozohet.

Segmenti i rrugës “Kastriot Muço” (kryqezimi me rrg. “Mujo Ulqinaku” deri tek kryqezimi me unazën “Skenderbeu” me ndërtimin e “BY-PASS” e Fierit u bë tashmë një segment i portës hyrëse për në qytet.

Përsa me siper, Bashkia Fier,

PROPOZON:

1. Të miratojë projektin për **zgjerimin** dhe rikonstruksionin e rrugës "Kastriot Muço" segmenti (kryqezimi me rr. "mujo ulqinaku"- kryqezimi me unazën "skenderbeu"), për vazhdimin e procedurave të mëtejshme ligjore.
2. Ngarkohet ekzekutivi i Bashkisë Fier të kryejë procedurat e shpronësimit, për realizimin e këtij projekti.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ekzekutivi i Bashkisë Fier.

Drejtorja e Programimit dhe Kontrollit
të Punëve Publike dhe Investimeve
Silvana Basha

Drejtorja Financë Buxhet dhe Kontabilitet
Pranvera Cina

Drejtorja e Projekteve të Infrastruktura
Haxhi Avdullai

Drejtorja Juridike
Esmeralda Kapllanaj

KRYETARI
Armando Subashi

